



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

VENDIM

Nr. 12, datë 28/04/2017

PROPOZIM PËR PËRFITIM PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 28/04/2017 në zbatim të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligjit Nr.7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", neni 5, (i ndryshuar), VKM –së Nr.429, datë 12.09.2002 "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme", pika 4 dhe 5, si dhe propozimit të Shoqatës së Shkrimtarëve dhe Artistëve "Petro Marko" për përfitim Pensioni të Posaçëm Shtetëror për z. Eqerem H Canaj,

VENDOSI;

1. Ti propozojë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhënien e Pensionit të Posaçëm Shtetëror **Z. Eqerem Hysen CANAJ**, për nivel të lartë letrar- artistik si shkrimtar me kontribut të veçantë në zhvillimin e letërsisë bashkëkohore.

2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari, Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve pranë Këshillit të Qarkut Vlorë.

3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretar i Këshillit të Qarkut

Vllasi Nasaj

Jurist

Alma Myrtaj

KRYETARI I KËSHILLIT TË QARKUT

Ervis MOÇKA

